



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

RrGGK publikon raportin e ri “Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale”

Nesër, prej orës 10:30, në Hotel Sirius, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) do të publikojë raportin e ri të titulluar “Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale”. Mediat ftohen të marrin pjesë.

Ky raport, përbën analizën e dytë gjinore të shpenzimeve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Analiza ka për synim ta ndihmojë Ministrinë në vlerësimin dhe planifikimin më të mirë të buxhetit të saj nga perspektiva gjinore.

Raporti “Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale” poashtu jep përgjigje në pyetjet:

- A përfitojnë gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë prej shërbimeve dhe shpenzimeve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale?
- Kush mendoni se përfiton më shumë prej pensioneve në Kosovë, burrat apo gratë? Po asistencës sociale?
- Cila grup-moshë e grave dhe burrave punësohet më shumë prej zyrave të punësimit?

Raporti jep rekomandime konkrete për secilin departament dhe divizion të MPMS, rreth planifikimit më të mirë të buxhetit të saj nga perspektiva gjinore.

Raporti poashtu jep të dhëna për Projektbuxhetin 2016 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili do të aprovohet së shpejti në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Hulumtimi është financuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), dhe është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

PRESS

www.womensnetwork.org • Rr. Hajrullah Abdullahu Nr 25 10000
Prishtinë, Kosovë • +381 (0) 38 245 850 •
info@womensnetwork.org